

THE COLLEGE BOARD

# PSAT™ 8/9 Test Directions Translated into <ALBANIAN> for Students 2018-2019 Only

**Notes to the Proctor:** This document should be printed and distributed once students are seated.

Students may use this document to read translations of the directions that are read aloud or printed in their test book.

Students may keep this document open and on their desk during the entire testing period.

Students may **not** be given additional time, unless approved as a separate accommodation.

Collect this document from each student at the end of testing and securely destroy it.

© 2018 The College Board. College Board is a registered trademark of the College Board. PSAT is a trademark owned by the College Board. Unauthorized copying or reuse of any part of this document is illegal.

## Pasqyra e lëndës

Shënime për studentin .....	3
1 Udhëzime për ditën e provimit .....	3
1.1 Para se të fillojë provimi .....	3
1.1.1 Shpërndarja e fletëve të përgjigjeve.....	5
1.1.2 Shpërndarja e librave të provimit .....	6
1.1.3 Plotësimi i informacioneve të librit të provimit dhe deklarata e certifikimit .....	6
1.1.3.1 Udhëzime për format specifik .....	7
1.1.4 Udhëzimet e kapakut të parmë .....	8
1.1.5 Udhëzimet e kapakut të pasmë.....	9
1.2 Dorëshkrimi 1: Koha standarde .....	10
1.2.1 Pjesa 1: Test i leximit .....	10
1.2.1.1 Gjatë pushimit .....	10
1.2.1.2 Pjesa 1 Udhëzime për librin e provimit.....	11
1.2.2 Pjesa 2: Testi i shkrimit dhe gjuhës.....	11
1.2.2.1 Pjesa 2 Udhëzime për librin e provimit.....	12
1.2.3 Pjesa 3: Testi i matematikës - Pa makinë llogaritëse .....	12
1.2.3.1 Gjatë pushimit .....	13
1.2.3.2 Pjesa 3 Udhëzime për librin e provimit.....	14
1.2.4 Pjesa 4: Testi i matematikës - Makina llogaritëse .....	16
1.2.4.1 Pjesa 4 Udhëzime për librin e provimit.....	17
2 Pas provimit.....	19
2.1 Largimi.....	19
2.1.1 Mbledhja e librave të provimit dhe materialeve të tjera të provimit .....	19
2.1.2 Përfundimi.....	19
2.1.3 Mbledhja e fletëve të përgjigjeve .....	19
2.1.3.1 Para se të largohen studentët .....	19

## Shënime për studentin

- Më poshtë është një përkthim i udhëzimeve që kontrollori juaj do t'i lexojë me zë. Këto udhëzime të përkthyer mund të mos përputhen fjalë për fjalë me atë që do të lexojë kontrollori; sidoqoftë, informacionet në thelb janë të njëjta. Nëse keni pyetje për atë që po lexon kontrollori, ju lutem ngrini dorën.
- Nëse ju duhet t'u referoheni udhëzimeve të përkthyer të librit të provimit, mund t'i gjeni ato në fund të çdo pjese provimi pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.
- Mund ta mbani këtë dokument mbi bankë për gjithë kohën e provimit, por duhet t'ia ktheni kontrollorit pas provimit.
- NUK lejohet ta përdorni këtë dokument për letër shënimesh.
- Në momente të ndryshme, kontrollori do të lajmërojë kohën e mbetur në një pjesë, si edhe pushimet kur është e përshtatshme. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, këto lajmërime mund të ndryshojnë nga oraret dhe pushimet e renditura në këtë dokument të përkthyer. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori.
- Nëse po bëni provim me akomodimet e aprovuara, kontrollori mund t'ju japë udhëzime të mëtejshme në anglisht.
- Në disa raste, shteti ose rrethi juaj mund të ketë udhëzime ose politika të veçanta në lidhje me fletën e përgjigjeve. Ju lutem dëgjoni dhe ndiqni me kujdes udhëzimet nga kontrollori në lidhje me mënyrën si të plotësoni të dhënat tuaja personale në fletën e përgjigjeve.
- Në këtë dokument janë përdorur ikona për të tërhequr vëmendjen tuaj në informacione të caktuara:



Informacione të rëndësishme



Udhëzimet e thëna me gojë nga kontrollori



Udhëzime që gjenden në librin e provimit

## 1 Udhëzime për ditën e provimit

### 1.1 Para se të fillojë provimi

*Kontrollori do të fillojë duke thënë:*




Mirë se vini në administrimin e PSAT 8/9. Ky provim do të fokusohet në ato që keni mësuar tashmë në shkollë. Ai ju jep mundësinë të shikoni se ku mund të keni nevojë të përmirësoheni në shkollën e mesme. Nëse po përdorni udhëzime të printuara që janë përkthyer, hapni tani broshurën për të më ndjekur ndërsa ju jap udhëzimet.

Para se të fillojmë provimin, do t'ju lexoj disa rregulla dhe udhëzime. Ju lutem dëgjoni me kujdes dhe mbani mend pyetjet derisa t'jua kërkoj.

Për provimin e sotëm, mund të përdorni vetëm një laps Numër 2 për të shënuar në fletën e përgjigjeve. Nuk lejohen lapsat mekanikë. Ju lutem ngrini dorën nëse nuk keni laps Numër 2 dhe unë do t'ju jap një.

*Pastaj kontrollori do të thotë:*

 Të gjithë studentët do të kenë mundësi të barabartë për të treguar aftësitë dhe njohuritë e tyre mbi këtë provim. Për këtë arsye, ka rregulla për t'u siguruar që askush të mos fitojë me padrejtësi. Do t'i eliminojmë dhe anulojmë rezultatet e kujtdo që bën diçka prej të mëposhtmeve:


- Jep ose merr ndihmë të çfarëdo lloji në provim
- Shikon në librin e provimit para se të fillojë provimi
- Punon në pjesën e gabuar ose kërkon në një pjesë të mëparshme ose të mëvonshme në librin e provimit ose fletën e përgjigjeve
- Shënon përgjigje pasi ka mbaruar koha
- Ndan pyetjet ose përgjigjet e provimit me cilindo gjatë ose pas provimit
- Përpiqet të heqë materialet e provimit nga dhoma e provimit
- Përdor mjete provimi të paautorizuara, përfshirë telefonat, gjatë provimit ose pushimeve

Gjithashtu mund të përjashtoheni nëse:


- Hani ose pini gjatë provimit (përveç nëse kjo është miratuar si lehtësi - përndryshe, ngrënia dhe pirja lejohen vetëm gjatë pushimeve)
- Shkaktoni shqetësime të çfarëdo lloji ose shpërqendroni për studentët e tjerë
- Largimi nga salla ose ndërtesa pa autorizim gjatë provimit ose pushimeve

A ka dikush ndonjë pyetje për diçka që kam thënë deri tani?

*Nëse shkolla ka mbledhur sendet personale të studentëve, kontrollori do të thotë:*

 Në këtë moment duhet të keni dorëzuar të gjithë telefonat ose çdo pajisje tjetër elektronike. Nëse dikush ka ende pajisje elektronike të çfarëdo lloji, ju lutem çaktivizoni alarmet, fikini dhe m'i dorëzoni mua tani. Të gjitha do t'ju kthehen në fund të provimit.


*Nëse shkolla juaj NUK ka mbledhur sendet e studentëve, kontrollori do të thotë:*

 Në këtë moment, nëse keni telefon apo ndonjë pajisje tjetër elektronike, duhet të çaktivizoni alarmet, ta fikni komplet, ta lini mënjanë në çantë e cila do të jetë poshtë bankës suaj derisa të mbarojë provimi. Çdo pajisje elektronike që nuk është fikur dhe lënë mënjanë mund t'ju merret dhe materialet në të të kontrollohen si pjesë e një investigimi dhe ju mund të përjashtoheni nga provimi.

Nëse keni marrë me vete ushqime ose pije për kohën e pushimit, nxirrini dhe vendosini poshtë bankës tani. Nuk do të lejoheni të futni duart në çanta gjatë pushimeve.

Mbyllini çantat dhe vendosini poshtë bankës derisa të mbarojë provimi.


*Pastaj kontrollori do të thotë:*

 Tani do të përgatitemi për të filluar provimin.

Ju lutem hiqni çdo gjë nga banka juaj përveç lapsave Numër 2 me fshirëse, makinave llogaritëse të aprovuara dhe çdo mjeti të aprovuar për provim.


Nëse keni marrë me vete makinë llogaritëse ose bateri rezervë, ju lutem vendosini mbi bankë. Nuk lejohet të përdorni të njëjtën makinë llogaritëse me një student tjetër në çfarëdo momenti gjatë provimit ose pushimeve.

*Kur të gjithë studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:*


 Faleminderit. Ju lutem rrini ulur me qetësi ndërsa hedh një sy një moment dhe sigurohem që të gjithë të kenë një makinë llogaritëse të aprovuar.

### 1.1.1 Shpërndarja e fletëve të përgjigjeve


*Kur studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:*

 Tani do t'i jap secilit prej jush një fletë përgjigjesh.


*Studentëve që përdorin fletë përgjigjesh me SHKRONJA TË MËDHA, kontrollori do t'u thotë:*

 Ju lutem lexoni udhëzimet në faqen 1 të fletës së përgjigjeve për mënyrën si t'i shënoni përgjigjet. Do të shënoni katrorët në vend se flluskat, dhe numrat e faqeve do të jenë ndryshe nga ato që lajmëroj unë. Ngrini dorën nëse ju duhet ndihmë në çfarëdo momenti.


*Për të gjithë studentët, kontrollori do të thotë:*

 Ju lutem kontrolloni për t'u siguruar që në fletën e përgjigjeve të jetë emri zyrtar dhe datëlindja juaj e saktë dhe që flluskat përkatëse të jenë plotësuar saktë. Ngrini dorën nëse keni marrë fletën e gabuar të përgjigjeve.

*Studentëve që duhet të mbushin fletët e përgjigjeve, kontrollori do t'u thotë:*

 Filloni duke plotësuar mbiemrin, emrin zyrtar dhe inicialin e atësisë nëse keni në fushën 1. Shkruani hapësira, viza ose apostrofë nëse këto janë pjesë e emrit tuaj. Nëse përfshini një emër tjetër përveç mbiemrit tuaj zyrtar, rezultatet tuaja mund të vonohen. Printoni shkronjat me të mëdha në kuti, pastaj plotësoni flluskat përkatëse. Sigurohuni që çdo shenjë të jetë e errët dhe të mbushë komplet flluskën. Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar. Ka ndonjë pyetje?


*(A) Për fushat 2–4, nëse ka studentë në klasën tuaj që NUK shkojnë në të njëjtën shkollë, kontrollori do të thotë:*

 Në fushën 2, nëse kjo është shkolla që ndiqni rregullisht, mbushni flluskën që thotë, «Po.» dhe vendosni emrin dhe adresën e shkollës tuaj në fushën 3. Nëse nuk është kjo shkolla që ndiqni rregullisht dhe nuk e ndiqni shkollën nga shtëpia, plotësoni flluskën e dytë që thotë, «Jo, kjo nuk është shkolla që ndjek rregullisht.» dhe vendosni emrin dhe adresën e shkollës suaj në fushën 3. Nëse bëni shkollën në shtëpi, plotësoni flluskën e tretë që thotë «Jo, ndjek shkollën nga shtëpia,» dhe mos vendosni asnjë informacion në fushën 3 se 4.


Në fushën 4, vendosni kodin e shkollës. Nëse ndiqni këtë shkollë, kam postuar kodin e shkollës sonë përpara sallës. Janë renditur gjithashtu kodet e shkollave të tjera për ata që u duhen. Nëse ndiqni shkollën nga shtëpia, lëreni fushën 4 bosh. Ju lutem ngrini kokën kur të keni mbaruar.

#### OSE

*(B) Për fushat 2–4, nëse të gjithë studentët e provimit në klasë ndjekin shkollën tuaj, kontrollori do të thotë:*

 Në fushën 2, mbushni flluskën që thotë, «Po.» dhe vendosni emrin dhe adresën e shkollës sonë në fushën 3. Në fushën 4, vendosni kodin e shkollës që kam postuar përpara sallës.


*(A) Nëse shkolla juaj përdor numra ID studentësh, për fushën 5, kontrollori do të thotë:*

 Në fushën 5, printoni dhe plotësoni numrin e identifikimit të studentit, duke filluar me kolonën e parë në të majtë. Nëse ka shkronja në numrin tuaj ID, kapërcejini dhe shkruani vetëm numrat. Nëse nuk e dini numrin tuaj ID, ngrini dorën. Ngrini kokën lart kur të keni mbaruar.

*(B) Nëse shkolla juaj NUK përdor numra ID studentësh, për fushën 5, kontrollori do të thotë:*

 Mos bëni shënime në fushën 5.

*Për fushën 6, kontrollori do të thotë:*

 Plotësoni nivelin tuaj aktual në fushën 6.

*Për fushën 7, kontrollori do të thotë:*

- Plotësoni flluskën përkatëse në fushën 7.

*Për fushën 8, kontrollori do të thotë:*

- Në fushën 8, plotësoni flluskën përkatëse për muajin kur keni lindur. Pastaj plotësoni ditën dhe 2 shifrat e fundit të vitit kur keni lindur, dhe plotësoni flluskat përkatëse. Çdo fushë me 2 shifra duhet të fillojë me zero nëse numri është më pak se 10. Nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha, plotësoni muajin, ditën, dhe vitin e lindjes.

### 1.1.2 Shpërndarja e librave të provimit

*Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:*

- Tani do t'ju jap librat tuaj të provimit. Kur të merrni librin e provimit, mos e hapni. Kthejeni mbrapsht dhe lexoni kapakun e pasmë. Aty ka informacione të rëndësishme rreth provimit dhe se si të shënoni si duhet përgjigjet tuaja.

*Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:*

- Printoni qartë emrin, kodin e kësaj shkolle dhe emrin e kësaj shkolle mbrapa librit të provimit. Nëse po përdorni format MP3 ose ATC në pajisje flesh, duhet të siguroheni që ky informacion është edhe në paketimin e pajisjes flesh. Ju lutem ngrini kokën kur të keni mbaruar.

Tani ktheni fletën e përgjigjeve në faqen 4 (ose faqen 7 nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha).

### 1.1.3 Plotësimi i informacioneve të librit të provimit dhe deklarata e certifikimit

*Për fushat A dhe B, kontrollori do të thotë:*

- Gjeni fushat A dhe B mbrapa fletëve të përgjigjeve (ose në faqen 7 të fletëve të përgjigjeve me shkronja të mëdha). Kopjoni kodin e formularit dhe ID-në e provimit saktësisht siç janë mbrapa librit të provimit (ose paketimin e pajisjes flesh për ata që bëjnë provimin me MP3 dhe ATC) në fushat A dhe B në fletën e përgjigjeve. Për fushën A, ju lutem plotësoni gjithashtu flluskat e përshtatshme. Ju lutem ngrini kokën kur të keni mbaruar.

*Për të gjithë studentët, kontrollori do të thotë:*

- Merrni një moment për t'u siguruar që fushat Form Code dhe Test ID janë plotësuar saktë. Është e domosdoshme që të vendosni kodet e sakta në fletën e përgjigjeve. Përndryshe, mund të mos merrni rezultatet.

*(A) Nëse shkolla juaj përdor kode për sallën e provimit, për fushën C, kontrollori do të thotë:*

- Në fushën C, shkruani kodin e sallës së provimit që kam postuar; pastaj plotësoni flluskat.

*(B) Nëse shkolla juaj NUK përdor kode të sallës së provimit, për fushën C, kontrollori do të thotë:*

- Ju lutem lëreni fushën C bosh.

*(A) Nëse shkolla juaj përdor kode opsionale, për fushën D, kontrollori do të thotë:*

- Studentët që ndjekin këtë shkollë, ju lutem vendosni numrin që kam postuar për ju në fushën D.

*(B) Nëse shkolla juaj NUK përdor kode opsionale, për fushën D, kontrollori do të thotë:*

- Ju lutem lëreni fushën D bosh.

*Për të gjithë studentët, kontrollori do të thotë:*

- Tani gjeni Deklaratën e Certifikimit në pjesën e pasme të fletës së përgjigjeve.

Duke firmosur këtë deklaratë, ju pranoni të mos ndani asnjë pyetje specifike të provimit me asnjë, në asnjë lloj forme komunikimi duke përfshirë email, mesazhe tekst, postime në internet, ose përdorim tjetër interneti. Bëra e kësaj mund të shkaktojë anulim të rezultatit ose sanksionim tjetër të mundshëm. Përveç kësaj, ju pranoni se nëse shkolla i jep College Board të dhëna rreth jush, College Board mund t'i ruajë ato të dhëna për të ofruar shërbime arsimore në lidhje me këtë provim të tilla si raportime dhe pranime e mundësi shkollimi.

Lexoni deklaratën dhe informacionet në broshurën e udhëzimeve, pastaj firmosni emrin tuaj të plotë siç do të bënit në një dokument zyrtar. Poshtë firmës suaj, printoni emrin dhe vendosni datën e sotme.

Sigurohuni ta plotësoni këtë pjesë. Nëse nuk shkruani emrin tuaj, rezultatet mund të vonohen ose të anulohen.

Vendoseni lapsin poshtë kur të keni mbaruar

*Kur të gjithë të kenë firmosur deklaratën e certifikimit, kontrollori do të thotë:*



Ju lutem lini makinat llogaritëse dhe bateritë rezervë poshtë bankës tani. Nuk do t'ju duhen për këtë pjesë.

Gjatë provimit, mbani fletën e përgjigjeve dhe librin e provimit të mbyllur mbi bankë. Nëse gjeni ndonjë gabim tek fleta e përgjigjeve ose libri i provimit, si për shembull një faqe që mungon, ngrini dorën. Unë do të sillmë nëpër sallë për të kontrolluar ecurinë tuaj. Gjithashtu do të mbaj orën zyrtare për provimin dhe do t'ju tregoj rregullisht sa kohë ju ka mbetur në çdo pjesë.

Mund ta përdorni librin e provimit për shënime, por përgjigjet duhet t'i shënoni në fletën e përgjigjeve përveç nëse aprovoheni t'i shënoni në librin e provimit. Pasi të jetë njoftuar mbarimi i kohës, nuk mundeni t'i kaloni përgjigjet nga libri i provimit në fletën e përgjigjeve ose të plotësoni flluskat bosh.

Nëse keni pyetje rreth procedurave të provimit, ju lutem bëjini tani. Nuk do të jem në gjendje t'u përgjigjem pyetjeve gjatë pjesëve me kohë të provimit.

### *1.1.3.1 Udhëzime për format specifike*

*Nëse një student përdor një kopjues, kontrollori do t'i thotë kopjuesit:*



Ju lutem ndiqni këto udhëzime:

- Duhet të shkruani vetëm çfarë dikton studenti.
- Nuk duhet ta pyesni studentin në mënyrë të tillë që do të sillte një përgjigje ndryshe.
- Nëse studenti përdor një fjalë që nuk e njihni ose që nuk dini si ta shkruani, kërkoni studentit ta gërmëzojë.

*Një studenti që përdor një kopjues, kontrollori do t'i thotë:*



Përgjigjet tuaja dhe çdo korrigjim do të regjistrohet ndërsa e diktoni. Nëse doni ta rishikoni punën, përgjigjet do t'ju lexohen me zë. A keni ndonjë pyetje?

*Një lexuesi, kontrollori do t'i thotë:*



Nëse po i lexoni skenarin një studenti, ju lutem lexoni pyetjet aq herë sa t'ju kërkohet. Është e rëndësishme të lexoni vetëm atë që është shkruar në skenar. Mos jepni shpjegime përtej asaj që përmban skenari edhe nëse jua kërkon studenti. Nëse një student që përdor shtojcën e figurës braille nuk lexon braille, mund të gjeni etiketat dhe numrat në vendet përkatëse në librat e zakonshëm nëse është e nevojshme. A keni ndonjë pyetje për këto procedura?

*Studentëve që përdorin formatin braille, kontrollori do t'ju thotë:*



Provimi në braille është i ndarë në disa libra. Do t'ju jepet nga një libër me radhë. Provimi i leximit dhe provimi i shkrimit dhe gjuhës janë në gjuhën braille të zakonshme të gradës 2. Gjatë provimit, çdo pyetje është e ndarë nga tjetra me një vijë. Çdo pyetje fillon në qelizën 1, me pjesët e shtypura që fillojnë në qelizën 5. Çdo alternativë përgjigjeje fillon në qelizën 3 me pjesët e shtypura që fillojnë në qelizën 5.

Lloji i gjuhës braille të përdorur është Unified English Braille (UEB), dhe provimi i matematikës është në Nemeth Code të rishikuar në 1972. Shtojca e figurës braille përfshin formula matematike dhe udhëzime në braille për t'ju përdorur me të dyja pjesët e provimit të matematikës.

Nëse përdorni një pajisje braille për të shënuar përgjigjet tuaja, në çdo faqe që përdorni, shkruani emrin e plotë dhe numrin e pjesës në të cilën po punoni. Shkruani numrin e pyetjes dhe përgjigjen tuaj. Nuk është e nevojshme të shkruani me gërma të mëdha përgjigjet tuaja.

A keni ndonjë pyetje për këto procedura?

*Të gjithë studentëve që përdorin një format ATC, kontrollori do t'ju thotë:*



Sot do të merrni një formular të provimit që është i pajtueshëm me lexuesin e ekranit tuaj ose softuer tjetër. Kam ngarkuar këtë format ndihmës me teknologji të pajtueshme në kompjuterin e bankës tuaj.

Ju lutem përgatituni për provimin tani duke hapur dhe lexuar dokumentin elektronik me temë «Udhëzime dhe informacione fillestare për përdoruesit e ATC.» Kur të keni mbaruar me leximin e dokumentit, ju lutem zgjidhni butonin e minimizimit dhe ngrini kokën.

Gjatë provimit, do të lexoni udhëzimet në ekran njëllor me studentët e tjerë që do t'i lexojnë në librat e provimit. Të gjitha udhëzimet për kohën dhe procedurat e tjera që kam lexuar zbatohen edhe për ju. Kur t'ju them të filloni provimin në një pjesë, hapni skedarin e pjesës së duhur dhe shkruani fjalëkalimin tuaj i cili është shtypur në paketimin e provimit. Kur të njoftoj për mbarimin e kohës, ndaloni provimin dhe mbylleni skedarin. Ka ndonjë pyetje?

#### 1.1.4 Udhëzimet e kapakut të parmë



*Më poshtë është një përkthimi i kapakut të parmë të librit të provimit.*

---

### PËRKUJTUES TË RËNDËSISHËM

1

Është i nevojshëm një laps nr. 2 për provimin.  
Mos përdorni laps mekanik ose stilolaps.

2

Ndarja e pyetjeve me cilindo është shkelje e politikave për sigurinë dhe drejtësinë e provimit dhe mund të bëjë që rezultatet tuaja të anulohen.

KY LIBËR PROVIMI NUK DUHET TË MERRET JASHTË SALLËS. NDALOHET RIPRODHIMI OSE PËRDORIMI I PAAUTORIZUAR I ÇFARËDO PJESE TË KËTIJ LIBRI PROVIMI.

© 2018 The College Board. College Board dhe logoja e lendes janë marka tregtare të regjistruara të College Board. PSAT është një markë që zotërohet nga College Board.

---



### 1.1.5 Udhëzimet e kapakut të pasmë



Më poshtë do të gjeni një përkthim të kapakut të pasmë të librit të provimit. Kur t'ju udhëzohet, duhet të shkruani në librin e provimit ose fletën e përgjigjeve, jo në këtë dokument përkthimesh.

Emri juaj (Me shtyp) \_\_\_\_\_

MBIEMRI

EMRI

MESËM

Shkolla \_\_\_\_\_

NUMRI

EMRI I SHKOLLËS

NUMRI I SALLËS

## PSAT™ 8/9

### UDHËZIME TË PËRGJITHSHME

- Lejohet të punoni vetëm në një rën pjesë me radhë.
- Nëse mbaroni një pjesë para se të jetë njoftuar mbarimi i kohës, kontrolloni punën tuaj në atë pjesë. NUK lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

### SHËNIMI I PËRGJIGJEVE

- Sigurohuni të shënoni si duhet fletën e përgjigjeve.

Shënim i plotë:

Shënime të paplota:



- Duhet të përdorni një laps nr. 2.
- Shënoni me kujdes një përgjigje për çdo pjesë.
- Sigurohuni të mbushni të gjithë filluskën me ngjyrë të errët dhe plotësisht.
- Mos bëni asnjë shënim të gabuar në fletën e përgjigjeve.
- Nëse e fshini, fshijeni plotësisht. Fshirjet që nuk janë bërë plotësisht mund të merren si përgjigje.
- Përdorni vetëm rreshtat e përgjigjeve që përkasin me numrat e pyetjeve.

### PËRDORIMI I LIBRIT TË PROVIMIT

- Mund ta përdorni librin e provimit për shënime personale, por nuk do të merrni pikë për asgjë që shkruani në librin e provimit.
- Pasi të jetë njoftuar mbarimi i kohës, nuk mundeni t'i kaloni përgjigjet nga libri i provimit në fletën e përgjigjeve ose të mbushni filluskat.
- Nuk lejohet të palosni ose hiqni faqet ose pjesë të një faqeje nga ky libër, ose të merrni me vete fletën e përgjigjeve jashtë sallës së provimit.

### REZULTATI

- Për çdo përgjigje të saktë, merrni një pikë.
- Nuk humbisni pikë për përgjigjet e gabuara; prandaj, duhet të përpiqeni t'i përgjigjeni çdo pyetjeje edhe nëse nuk jeni të sigurt për përgjigjen e saktë.

Idetë që ndodhen në pasazhet për këtë provim, disa prej të cilave janë të nxjerra ose përshtatura nga materiali i botuar, nuk tregojnë medoemos opinionet e College Board.

**MOS E HAPNI KËTË LIBËR DERISA T'JU THOTË KONTROLLORI.**

### E RËNDËSISHME

Kodet më poshtë janë unike për librin tuaj të provimit. Kopjojini në fletën e përgjigjeve në kutitë A dhe B dhe mbushni filluskat përkatëse saktësisht siç tregohet.

A Form Code						
A	B	C	D	1	2	3
●	A	A	A	0	0	0
●	B	B	B	1	1	1
●	C	C	C	2	2	2
●	D	D	D	3	3	3
●	E	E	E	4	4	4
●	F	F	F	5	5	5
●	G	G	G	6	6	6
●	H	H	H	7	7	7
●	I	I	I	8	8	8
●	J	J	J	9	9	9
●	K	K	K			
●	L	L	L			
●	M	M	M			
●	N	N	N			
●	O	O	O			
●	P	P	P			
●	Q	Q	Q			
●	R	R	R			
●	S	S	S			
●	T	T	T			
●	U	U	U			
●	V	V	V			
●	W	W	W			
●	X	X	X			
●	Y	Y	Y			
●	Z	Z	Z			

B Test ID						
1	2	3	4	5	6	7

## 1.2 Dorëshkrimi 1: Koha standarde

### 1.2.1 Pjesa 1: Test i leximit



*Koha standarde për pjesën 1 është **55 minuta**, me një **pushim 5-minutësh** në fund të pjesës. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.*

*Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:*



Mos e hapni librin e provimit derisa t'ju them unë. Pasi të fillojmë, do të keni 55 minuta kohë për të punuar me pjesën 1, testin e leximit. Do të bëjmë një pushim prej 5 minutash kur të ketë mbaruar kjo pjesë.

Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 1. Sigurohuni të përdorni një laps numër 2 dhe që të mbushni të gjithë flluskën me ngjyrë të errët dhe komplet. Nëse e ndryshoni përgjigjen, fshijeni sa më shumë të jetë e mundur. Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por NUK lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Mos harroni se merrni pikë për përgjigjet e sakta por nuk humbisni pikë për përgjigjet e gabuara. Kjo do të thotë se duhet të përqipeni t'i përgjigjeni çdo pyetje edhe nëse nuk jeni i sigurt për përgjigjen e saktë.

Ju lutem ktheni fletën e përgjigjeve në pjesën 1 në faqen 3 (ose faqen 9 nëse po përdorni fletë përgjigjesh në bllok të madh). Mbajeni fletën e përgjigjeve të hapur dhe mbi bankë. Mos i palosni faqet nga pas. Hapni librin e provimit në pjesën 1, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani. Suksese.

*Pas 30 minutash, kontrollori do të thotë:*



Keni 25 minuta të mbetura në këtë pjesë.

*Pas 50 minutash, kontrollori do të thotë:*



Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

*Pas saktësisht 55 minutash, kontrollori do të thotë:*



Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë.

Mbylleni fletën e përgjigjeve dhe vendoseni mbi faqen në librin e provimit ku keni ndaluar së punuari. Mbylleni librin e provimit.

Tani do të keni disa minuta për t'u çlodhur. MOS i diskutoni pyetjet e provimit gjatë pushimit ose mos u largoni nga dhoma e provimit pa leje.

Do të fillojmë provimin përsëri pas saktësisht 5 minutash.

*Nëse shkolla juaj NUK ka grumbulluar sendet personale të studentëve, kontrollori do të thotë:*



Nuk lejohet të keni ose përdorni telefon ose asnjë pajisje tjetër elektronike në këtë pushim ose në asnjë pushim tjetër gjatë provimit. Të gjithë telefonat dhe pajisjet e tjera duhet të mbeten të fikura dhe të lihen mënjanë derisa të mbarojë provimi.

#### 1.2.1.1 Gjatë pushimit

*Në fund të pushimit, kontrollori do të thotë:*



Ju lutem uluni. Mos e hapni librin e provimit derisa t'ju them unë.

### 1.2.1.2 Pjesa 1 Udhëzime për librin e provimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 1 të librit të provimit.

---

#### 55 MINUTA, 42 PYETJE (KOHA STANDARDE)

Kthehuni te pjesa 1 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.

##### UDHËZIME

Pas çdo fragmenti ose çifti fragmentesh më poshtë ka një numër pyetjesh. Pasi të keni lexuar çdo fragment ose çift fragmentesh, zgjidhni përgjigjen më të mirë për t'iu përgjigjur pyetjes duke u bazuar në atë çka është thënë ose nënkuptuar në fragment ose fragmente dhe në çdo grafik të shoqëruar (si tabelë ose diagram).

---

### 1.2.2 Pjesa 2: Testi i shkrimit dhe gjuhës



Koha standarde për pjesën 2 është **30 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.

Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:



Pasi të fillojmë, do të keni 30 minuta kohë të punoni me pjesën 2, testin e shkrimit dhe gjuhës.

Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 2. Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por NUK lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Hapni librin e provimit në faqen ku keni futur fletën e përgjigjeve. Gjeni pjesën 2 në faqen 3 të fletës së përgjigjeve (ose faqen 11 nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha). Mbajeni fletën e përgjigjeve të hapur dhe mbi bankë. Mos i palosni faqet nga pas. Tani, ju lutem kaloni në pjesën 2 të librit të provimit, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.

Pas 15 minutash, kontrollori do të thotë:



Keni 15 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas 25 minutash, kontrollori do të thotë:



Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

Pas saktësisht 30 minutash, kontrollori do të thotë:



Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë.

Mbylleni fletën e përgjigjeve dhe vendoseni mbi faqen në librin e provimit ku keni ndaluar së punuari. Mbylleni librin e provimit.

### 1.2.2.1 Pjesa 2 Udhëzime për librin e provimit



Më poshtë keni një përktim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 2 të librit të provimit.

#### 30 MINUTA, 40 PYETJE (KOHA STANDARDE)

**Kthehuni te pjesa 2 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.**

#### UDHËZIME

Çdo fragment më poshtë shoqërohet nga një numër pyetjesh. Për disa pyetje, do të mendoni si mund të ndryshohet fragmenti për të përmirësuar shprehjen e ideve. Për pyetje të tjera, do të mendoni si mund të redaktohet fragmenti për të korrigjuar gabimet në strukturën, përdorimin ose shenjat e pikësimit të fjalive. Një fragment ose një pyetje mund të shoqërohet me një ose më shumë grafikë (si për shembull tabelë ose diagram) të cilat do t'i merrni parasysh ndërsa merrni vendime për ndërhyrje dhe redaktime.

Disa pyetje do t'ju drejtojnë te një pjesë e nënvizuar e një fragmenti. Pyetje të tjera do t'ju drejtojnë në një vend në fragment ose do t'ju kërkojnë të mendoheni për të gjithë fragmentin.

Pasi të keni lexuar çdo fragment, zgjidhni përgjigjen për t'iu përgjigjur pyetjes që përmirëson më së miri cilësinë e shkrimit në fragment ose që e bën fragmentin të përputhet me rregullat e gjuhës angleze të shkruar standarde. Shumë pyetje mund të kenë një opsion «ASNJË NDRYSHIM». Zgjidhni atë opsion nëse mendoni se është zgjedhja më e mirë është ta lini siç është pjesën përkatëse të fragmentit.

### 1.2.3 Pjesa 3: Testi i matematikës - Pa makinë llogaritëse



*Koha standarde për pjesën 3 është **20 minuta**, me një **pushim 5-minutësh** në fund të pjesës. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Përktimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përktiera me gojë.*

*Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:*



Pasi të fillojmë, do të keni 20 minuta kohë të punoni me pjesën 3, testin e matematikës pa makinë llogaritëse. Do të bëjmë një pushim prej 5 minutash kur të ketë mbaruar kjo pjesë.

Megjithëse kjo është një pjesë e testit të matematikës, NUK ju lejohe të përdorni makinë llogaritëse përveç nëse është aprovuar të përdorni një makinë llogaritëse me katër funksione si akomodim. Përndryshe, ju lutem mbajeni makinën llogaritëse poshtë bankës.

Hapni librin e provimit në faqen ku keni futur fletën e përgjigjeve. Gjeni pjesën 3 në faqen 3 të fletës së përgjigjeve (ose faqen 13 nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha). Mbajeni fletën e përgjigjeve të hapur dhe mbi bankë. Mos i palosni faqet nga pas. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 3. Në librin e provimit gjenden udhëzime se si të vendosni përgjigjen tuaj në pyetjet e emërtuara Përgjigjet e bëra nga studenti. Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të jenë më të shkurtra, por jo më të gjata se 4 karaktere.

Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por NUK lejohe të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Tani, ju lutem kaloni në pjesën 3 të librit të provimit, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.

*Pas 10 minutash, kontrollori do të thotë:*




Keni 10 minuta të mbetura në këtë pjesë.

*Pas 15 minutash, kontrollori do të thotë:*



Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

*Pas saktësisht 20 minutash, kontrollori do të thotë:*

 Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë.


Mbylleni fletën e përgjigjeve dhe vendoseni mbi faqen në librin e provimit ku keni ndaluar së punuari.  
Mbylleni librin e provimit.

Tani do të keni disa minuta për t'u çlodhur. MOS i diskutoni pyetjet e provimit gjatë pushimit ose mos u largoni nga dhoma e provimit pa leje.

Do të fillojmë provimin përsëri pas saktësisht 5 minutash.

### *1.2.3.1 Gjatë pushimit*

*Në fund të pushimit, kontrollori do të thotë:*

 Ju lutem uluni. Mos e hapni librin e provimit derisa t'ju them unë.

### 1.2.3.2 Pjesa 3 Udhëzime për librin e provimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 3 të librit të provimit.

**20 MINUTA, 13 PYETJE (KOHJA STANDARDE)**

Kthehuni te pjesa 3 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.


#### UDHËZIME

Për pyetjet 1–10, zgjidhni çdo problem, zgjidhni përgjigjen më të mirë nga alternativat e dhëna dhe mbushni rrethin përkatës në fletën e përgjigjeve. Për pyetjet 11–13, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë në fletën e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 11 se si të vendosni përgjigjet tuaja në tabelë. Mund të përdorni çdo hapësirë në dispozicion në librin e provimit për shënime personale.


#### SHËNIME

1. Nuk lejohet përdorimi i një makine llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një funksioni të dhënë  $f$  është grupi i të gjithë numrave realë  $x$  për të cilët  $f(x)$  është një numër real.


#### REFERENCË




$$A = \pi r^2$$
$$C = 2\pi r$$




$$A = \ell w$$




$$A = \frac{1}{2}bh$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$




Trekëndësja kënddrejtë  
të posaçëm




$$V = \ell wh$$



$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është  $2\pi$ .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

**UDHËZIME**

**Për pyetjet 11-13,** zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë, siç tregohet më poshtë, në fletën e përgjigjeve.

- Megjithëse nuk kërkohet, sugjerohet që të shkruani përgjigjen tuaj në kutitë në pjesën e sipërme të kolonave për t'ju ndihmuar të mbushni flluskat saktë. Do merrni pikë vetëm nëse flluskat janë mbushur saktë.
- Shënoni jo më shumë se një flluskë në çdo kolonë.
- Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
- Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të saktë. Në këto raste, shënoni vetëm një përgjigje.

5. **Numrat e përzierë të tillë** si  $3\frac{1}{2}$  duhet të shënohen si 3.5 ose 7/2. (Nëse 

3	1	/	2
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

 vendoset në tabelë, do të interpretohet si  $\frac{31}{2}$ , jo si  $3\frac{1}{2}$ .)

6. **Përgjigjet dhjetore:** Nëse merrni një përgjigje dhjetore me më shumë shifra nga sa mund të mbajë tabela, mund të rrumbullakoset ose shkurtohet, por duhet të mbushë të gjithë tabelën.

**Përgjigja:  $\frac{7}{12}$**

Shkruani përgjigjen në kuti. →

7	/	1	2
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
<input checked="" type="checkbox"/>	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

← Vija e thyesës

Vendosni në tabelë rezultatin

**Përgjigja: 2.5**

	2	.	5
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	<input checked="" type="checkbox"/>	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	<input checked="" type="checkbox"/>
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

← Pika dhjetore

**Mënyrat e pranueshme për të vendosur në tabelë  $\frac{2}{3}$  janë:**

	2	/	3
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	<input checked="" type="checkbox"/>	2	2
3	3	3	<input checked="" type="checkbox"/>
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8

.	6	6	6
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
7	7	7	7
8	8	8	8

.	6	6	7
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>
7	7	7	<input checked="" type="checkbox"/>
8	8	8	8

**Përgjigja: 201 - secili pozicion është i saktë**

	2	0	1
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
0	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	0
1	1	1	<input checked="" type="checkbox"/>
2	<input checked="" type="checkbox"/>	2	2
3	3	3	3

	2	0	1
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
0	<input checked="" type="checkbox"/>	0	0
1	1	<input checked="" type="checkbox"/>	1
2	<input checked="" type="checkbox"/>	2	2
3	3	3	3

**SHËNIM:** Mund t'i filloni përgjigjet tuaja në cilëndo kolonë nëse jua lejon hapësira. Kolonat që nuk keni nevojë t'i përdorni duhet të lihen bosh.

## 1.2.4 Pjesa 4: Testi i matematikës - Makina llogaritëse



*Koha standarde për pjesën 4 është **40 minuta**. Nëse po bëni provimin me një lehtësi të miratuar, koha dhe pushimet mund të jenë ndryshe. Ju lutem dëgjoni me kujdes lajmërimet që ju lexohen nga kontrollori. Përkthimi i udhëzimeve të librit të provimit shfaqet pas udhëzimeve të përkthyer me gojë.*

*Kur studentët të jenë gati, kontrollori do të thotë:*



Kjo është pjesa e fundit e provimit, pothuajse keni mbaruar! Pasi të fillojmë, do të keni 40 minuta kohë të punoni me pjesën 4, testin e matematikës me makinë llogaritëse.

Për këtë pjesë mund të përdorni makinën llogaritëse; ju lutem vendosni makinën llogaritëse mbi bankë tani. Kur të përdorni makinën llogaritëse, ndiqni këto udhëzime:

- Mbajeni shtrirë mbi bankë ose mbajeni në mënyrë të tillë që studentët të mos shohin dot punën tuaj.
- Mos e ndani ose mos e shkëmbeni makinën llogaritëse me asnjë tjetër.
- Nëse keni marrë makinë llogaritëse ose bateri rezervë, mbajini në dyshe poshtë bankës tuaj.
- Nëse makina juaj llogaritëse prishet dhe keni bateri ose makinë llogaritëse rezervë, ngrini dorën. Do të vij t'ju ndihmoj. Nëse nuk keni rezervë, vazhdoni me provimin. Të gjitha pyetjeve të matematikës mund t'ju jepet përgjigje edhe pa makinë llogaritëse.

Hapni librin e provimit në faqen ku keni futur fletën e përgjigjeve. Gjeni pjesën 4 në faqen 3 të fletës së përgjigjeve (ose faqen 15 nëse po përdorni fletë përgjigjesh me shkronja të mëdha). Mbajeni fletën e përgjigjeve të hapur dhe mbi bankë. Mos i palosni faqet nga pas. Sigurohuni të shënoni përgjigjet tuaja në hapësirat me numra që përkasin me pyetjet e provimit me numra në pjesën 4. Në librin e provimit gjenden udhëzime se si të vendosni përgjigjen tuaj në pyetjet e emërtuara Përgjigjet e bëra nga studenti. Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të jenë më të shkurtra, por jo më të gjata se 4 karaktere.

Nëse mbaroni para se të njoftohet mbarimi i kohës, mund të kontrolloni punën tuaj në këtë pjesë, por nuk lejohet të kaloni në asnjë pjesë tjetër.

Tani, ju lutem kaloni në pjesën 4 të librit të provimit, lexoni udhëzimet dhe filloni punën. Koha fillon tani.

*Pas 20 minutash, kontrollori do të thotë:*



Keni 20 minuta të mbetura në këtë pjesë.

*Pas 35 minutash, kontrollori do të thotë:*



Keni 5 minuta të mbetura në këtë pjesë.

*Pas saktësisht 40 minutash, kontrollori do të thotë:*



Ndaloni punën dhe lini lapsin poshtë.

Mbylleni fletën e përgjigjeve në mënyrë që faqja 1 të jetë sipër. Mbylleni librin e provimit dhe vendoseni mbi fletën e përgjigjeve.

Urime, sapo mbaruat provimin! Ju lutem qëndroni ulur derisa t'ju liroj.



### 1.2.4.1 Pjesa 4 Udhëzime për librin e provimit



Më poshtë keni një përkthim të udhëzimeve që gjenden në fillim të pjesës 4 të librit të provimit.

#### 40 MINUTA, 25 PYETJE (KOHJA STANDARDE)

Kthehuni te pjesa 4 në fletën e përgjigjeve për t'iu përgjigjur pyetjeve në këtë pjesë.


#### UDHËZIME

Për pyetjet 1–21, zgjidhni çdo problem, zgjidhni përgjigjen më të mirë nga alternativat e dhëna dhe mbushni rrethin përkatës në fletën e përgjigjeve. Për pyetjet 22–25, zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë në fletën e përgjigjeve. Ju lutem shikoni udhëzimet para pyetjes 22 se si të vendosni përgjigjet tuaja në tabelë. Mund të përdorni çdo hapësirë në dispozicion në librin e provimit për shënime personale.

#### SHËNIME


1. Lejohet përdorimi i makinës llogaritëse.
2. Të gjitha ndryshoret dhe shprehjet e përdorura tregojnë numra realë përveç nëse tregohet ndryshe.
3. Figurat e dhëna në këtë provim janë vizatuar në raporte proporcionale përveç nëse tregohet ndryshe.
4. Të gjitha figurat janë vendosur në plan të rrafshët përveç nëse tregohet ndryshe.
5. Përveç nëse tregohet ndryshe, integrali i një funksioni të dhënë  $f$  është grupi i të gjithë numrave realë  $x$  për të cilët  $f(x)$  është një numër real.

#### REFERENCË




$$A = \pi r^2$$


$$C = 2\pi r$$




$$A = \ell w$$





$$A = \frac{1}{2}bh$$




$$c^2 = a^2 + b^2$$




Trekëndësja kënddrejtë  
të posaçëm




$$V = \ell wh$$



$$V = \pi r^2 h$$



$$V = \frac{4}{3}\pi r^3$$



$$V = \frac{1}{3}\pi r^2 h$$



$$V = \frac{1}{3}\ell wh$$

Numri i gradëve të harkut në një rreth është 360.

Numri i radianëve të harkut në një rreth është  $2\pi$ .

Shuma e matjeve në gradë e këndeve të një trekëndëshi është 180.

## UDHËZIME

**Për pyetjet 22-25,** zgjidhni problemin dhe vendosni përgjigjen tuaj në tabelë, siç tregohet më poshtë, në fletën e përgjigjeve.

- Megjithëse nuk kërkohet, sugjerohet që të shkruani përgjigjen tuaj në kutitë në pjesën e sipërme të kolonave për t'ju ndihmuar të mbushni rrathët saktë. Do merrni pikë vetëm nëse rrathët janë mbushur saktë.
- Shënoni jo më shumë se një rreth në çdo kolonë.
- Asnjë pyetje nuk ka përgjigje negative.
- Disa probleme mund të kenë më shumë se një përgjigje të saktë. Në këto raste, shënoni vetëm një përgjigje.

- Numrat e përzierë të tillë si  $3\frac{1}{2}$**  duhet të shënohen

si 3.5 ose 7/2. (Nëse 

3	1	/	2
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

 vendoset në tabelë,

do të interpretohet si  $\frac{31}{2}$ , jo si  $3\frac{1}{2}$ .)

- Përgjigjet dhjetore:** Nëse merrni një përgjigje dhjetore me më shumë shifra nga sa mund të mbajë tabela, mund të rrumbullakoset ose shkurtohet, por duhet të mbushë të gjithë tabelën.

**Përgjigja:  $\frac{7}{12}$**

Shkruani përgjigjen në kuti. →

7	/	1	2
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
<input checked="" type="radio"/>	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

← Vija e thyesës

Vendosni në tabelë rezultatin

**Përgjigja: 2.5**

	2	.	5
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	<input checked="" type="radio"/>	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	<input checked="" type="radio"/>
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8
9	9	9	9

← Pika dhjetore

### Mënyrat e pranueshme për të vendosur në tabelë $\frac{2}{3}$ janë:

	2	/	3
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	<input checked="" type="radio"/>	2	2
3	3	3	<input checked="" type="radio"/>
4	4	4	4
5	5	5	5
6	6	6	6
7	7	7	7
8	8	8	8

.	6	6	6
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	<input checked="" type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>
7	7	7	7
8	8	8	8

.	6	6	7
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	0	0	0
1	1	1	1
2	2	2	2
3	3	3	3
4	4	4	4
5	5	5	5
6	<input checked="" type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>
7	7	7	<input checked="" type="radio"/>
8	8	8	8

### Përgjigja: 201 - secili pozicion është i saktë

	2	0	1
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	<input checked="" type="radio"/>	<input checked="" type="radio"/>	0
1	1	1	<input checked="" type="radio"/>
2	<input checked="" type="radio"/>	2	2
3	3	3	3

	2	0	1
<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
0	<input checked="" type="radio"/>	0	0
1	1	<input checked="" type="radio"/>	1
2	<input checked="" type="radio"/>	2	2
3	3	3	3


**SHËNIM:** Mund t'i filloni përgjigjet tuaja në cilëndo kolonë nëse jua lejon hapësira. Kolonat që nuk keni nevojë t'i përdorni duhet të lihen bosh.

## 2 Pas provimit

### 2.1 Largimi

#### 2.1.1 Mbledhja e librave të provimit dhe materialeve të tjera të provimit

*Kur të gjithë të jenë gati, kontrollori do të thotë:*


-  Tani do të mbledh librat e provimit. Ju lutem mbajini fletët e përgjigjeve rrafsh mbi bankë dhe rrini ulur pa zhurmë.

*Për përdoruesit e MP3 dhe ATC, kontrollori do të thotë:*

-  Tani do të mbledh pajisjet tuaja flesh.

#### 2.1.2 Përfundimi

*Studentëve që duhet të plotësojnë informacionet e identifikimit në fletën e përgjigjeve, kontrollori do t'u thotë:*

-  Ju lutem rrini ulur me qetësi ndërsa liroj studentët e tjerë. Pastaj do t'ju udhëzoj si të plotësoni të dhënat tuaja personale në fletën e përgjigjeve. Nuk mund t'ju le të lirë derisa të plotësohen ato të dhëna.


#### 2.1.3 Mbledhja e fletëve të përgjigjeve

*Studentëve që kanë plotësuar fletët e përgjigjeve, kontrollori do t'u thotë:*

-  Tani do të mbledh fletët tuaja të përgjigjeve. Ju lutem rrini ulur me qetësi derisa t'ju le të lirë.

##### 2.1.3.1 Para se të largohen studentët

*Pasi të jenë marrë të gjitha materialet, kontrollori do të thotë:*

-  Do t'ju liroj shumë shpejt. Mos harroni: Në asnjë rrethanë, nuk duhet të merrni me vete përmbajtjet e provimit jashtë sallës së provimit apo t'i diskutoni përmbajtjet e provimit me asnjë tjetër dhe në asnjë lloj forme, përfshirë me email, mesazhe tekst, internet ose aplikacione rrjetesh sociale.

Do të njoftoheni kur të jenë në dispozicion rezultatet tuaja dhe si të shikoni online raportin e plotë të rezultateve nëse jeni të paktën 13 vjeç. Nëse jeni 13 vjeç e sipër, do të keni gjithashtu mundësi të lidheni me Khan Academy për praktikë të personalizuar në bazë të rezultateve tuaja specifike të provimit.

Administrimi i provimit tani ka mbaruar. Urime përsëri, dhe faleminderit për pjesëmarrjen dhe për gjithë punën tuaj të vështirë. Tani jeni të lirë të merrni gjërat tuaja dhe të largoheni nga dhoma.